



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA SHKODËR
SEKTORI I PLANIFIKIMIT TË MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTRËS

RELACION TEKNIK

**OBJEKTI: "SHËRBIME PËR MIRËMBAJTJE EMERGJENTE TË RRUGËVE TË QYTETIT
DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE, BASHKIA SHKODËR".**

**LOTI I-RË "SHËRBIME PËR MIRËMBAJTJE EMERGJENTE TË RRUGËVE TË QYTETIT
DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE, BASHKIA SHKODËR".**

**LOTI I II-TË "SHËRBIME PËR MIRËMBAJTJE EMERGJENTE TË SEGMENTIT " URA E
MESIT- PREKAL - KIR – MALI I SHOSHIT - BREG LUMI – NDERLYSAJ- THETH".**

Përshkrimi

Moti në dimer shpesh herë është i paparashikueshëm, me intensitet të ndryshueshëm gjatë periudhave pak a shumë të gjata kohore, dhe kërkon një qasje fleksibel në sigurimin e shërbimeve. Kushtet për udhëtimin e automjeteve dhe siguria në rrugë gjatë dimrit janë mjaft të kufizuara nga bora dhe akulli.

Për ti paraprirë situatave të pritshme gjatë stinëve të vjeshtës dhe të dimrit nga reshjet dhe ngricat kryesisht në Njësitë Administrative malore por dhe ato fushore, në mungesë të kapaciteteve logjistike të bashkisë është e nevojshme realizimi i këtyre shërbimeve me kontrate shërbimi me operatore ekonomik. Nisur nga eksperienca e viteve të mëparshme për të ofruar shërbimin në kohë sa më të shpejte, duke pare shtrirjen shumë të madhe gjeografike të rrjetit rrugor në njësite administrative me terren fushor e malor është bërë parashikimi me ndarje në dy zona shërbimi duke përshtatur mjetet në dispozicion sipas karakteristikave të terrenit si me poshtë:

1. LOTI I-RË “SHËRBIME PËR MIRËMBAJTJE EMERGJENTE TË RRUGËVE TË QYTETIT DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE, BASHKIA SHKODËR”.

Duke u nisur nga problemikat që krijohen në rrugët e qytetit dhe të Njësite administrative në periudhën e dimrit nga ngricat, reshjet e borës si dhe inertet e rëna në trupin e rrugës nga shirat e mëdha, është e nevojshme planifikimi i fondeve nga emrgjencat për pastrimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Për të përballuar situatat në rrjetin rrugor të shkaktuar nga kushtet e rënduara atmosferike duhet ndërhyrje emergjente për:

1. Sigurimin e qëndrueshmerisë dhe funksionalitetit të rrjetit rrugor nëpërmjet shërbimeve të mirëmbajtjes emergjente;
2. Përmirësimin e kushteve të levizjes dhe rritjen e sigurisë rrugore për të gjithë përdoruesit e rrugës;
3. Zvoglim të kohës së udhëtimit dhe uljen e kostos së amortizimit të mjeteve duke siguruar aksesin e lëvizjes për rastet e bllokimit të përkohshëm apo vështirsisë së lëvizjeve për shkak të fenomeneve natyrore;
4. Ndërhyrjen për çbllokimin në kohë dhe përmirësimin e aksesit të levizjeve në infrastrukturë dhe lidhja e rrugëve rurale me rrugët nacionale, qendrat e fshatrave me rrugët nacionale dhe qendrat e fshatrave me rrrugët brenda njësite administrative;
5. Pastrimin e borës;
6. Shmangjen e ngricave;
7. Masat kundër akullit;
8. Largimin e gurëve të rënë nga rruga;

9. Shpërndarjen e kripës me shpërndarës automatik të lidhur për automjeti;

Për të përballuar situatat e mësipërme janë parashikuar:

1. Dispozicion borepastruese per punime

hapje rruge nga bora ne raste emergjente 2 cope

2. Dispozicion fadrome per punime

hapje rruge ne raste emergjencash 1 cope

2. LOTI I II-TË “SHËRBIME PËR MIRËMBAJTJE EMERGJENTE TË SEGMENTIT “ URA E MESIT- PREKAL - KIR – MALI I SHOSHIT - BREG LUMI – NDERLYSAJ- THETH”.

Duke u nisur nga problemikat e theksuara që krijohen në aksin rrugor “Ura e Mesit- Prekal - Kir – Mali I Shoshit - Breg Lumi – Nderlysj- Theth”, në periudhën e dimrit nga ngricat, reshjet e borës si dhe inertet e rena në trupin e rrugës nga shirat e mëdha, është e nevojshme planifikimi I fondeve nga emregjencat për pastrimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Bllokimi I rrugëve në segmentin “ Ura e Mesit- Prekal - Kir – Mali I Shoshit - Breg Lumi – Nderlysj- Theth” është shumë I shpeshtë për shkak të terrenit të theksuar malor të zonës ku përveç izolimit të banorëve të zonës bllokimi I rrugëve përbën rrezik edhe për aksidente nga përdoruesit e rrugës.

Për të përballuar situatat në rrjetin rrugor të shkaktuar nga kushtet e rënduara atmosferike duhet ndërhyrje emergjente për:

1. Sigurimin e qëndrueshmerisë dhe funksionalitetit të rrjetit rrugor nëpërmjet shërbimeve të mirëmbajtjes emergjente;
2. Përmirësimin e kushteve të levizjes dhe rritjen e sigurisë rrugore për të gjithë përdoruesit e rrugës;
3. Zvoglim të kohës së udhëtimit dhe uljen e kostos së amortizimit të mjeteve duke siguruar aksesin e lëvizjes për rastet e bllokimit të përkohshëm apo vështirsisë së lëvizjeve për shkak të fenomeneve natyrore;
4. Ndërhyrjen për çbllokimin në kohë dhe përmirësimin e aksesit të levizjeve në infrastrukturë;
5. Pastrimin e borës;
6. Shmangjen e ngricave;
7. Masat kundër akullit;
8. Largimin e gurëve të rëna nga rruga.

Për të përballuar situatat e mësipërme janë parashikuar:

1. Dispozicion eskavator 0.35-0.4m3 për punime

hapje rruge në raste emergjente 1 cope

2. Dispozicion fadrome për punime

hapje rruge në raste emergjente

1 cope

Vlera e shërbimit

Vlera e shërbimit për objektin: *“Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të Qytetit dhe Njësive Administrative, Bashkia Shkodër”* është:

- *Loti i I-rë “Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të Qytetit dhe Njësive Administrative, Bashkia Shkodër”*: 2,606,400 leke me tvsh.
- *Loti i II-të “Shërbime për mirëmbajtje emergjente te segmentit “Ura e Mesit- Prekal - Kir – Mali i Shoshit - Breg Lumi – Nderlytaj- Theth”* : 2,390,400 leke me tvsh.

Afati i kontratës

Shërbimi do të realizohet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, Bashkia Shkodër në periudhën e kërkuar prej saj për përdorim sipas nevojave për rastet emergjente të rrugëve të Qytetit dhe Njësive Administrative të Bashkisë Shkodër.

Shërbimi I mirëmbajtjes për rastet emergjente parashikohet të realizohet brenda 6 muajve nga data e lidhjes së kontratës, sipas situatave që paraqiten nga kushtet e pa parashikuara atmosferike dhe emergjente të specifikuar më sipër për shkak të fenomeneve natyrore.

Punoi:

Spektori I Planifikimit të Mirëmbajtjes së Infrastrukturës

Ing. Bardha Jukni

Ing. Arber Kraja